

VENDIM
Nr.1250, datë 10.9.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT
“LIDHJA E QYTETIT BERAT-PËRMET”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit “Lidhja e qytetit Berat-Përmet”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme të shpronësohet, për sipërfaqen 150 (njëqind e pesëdhjetë) m², tokë truall, e vlerësuar me 1 831 (një mijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekë/m², për sipërfaqen 200 (dyqind) m², tokë arë, e vlerësuar me 851 (tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë/m², për objekt, me vlerë 2 193 973 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, dhe dru frutorë, vlerësuar me 77 500 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 716 323 (dy milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tre) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 716 323 (dy milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tre) lekë, të përballohet nga buxheti shtesë i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të fillojë më 15 shtator dhe të përfundojë më 1 nëntor 2008.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE TË
CILAT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË OBJEKTIT LIDHJA E
QYTETIT BERAT-PËRMET**

Emri Mbiemri	Sip. truall	Çmimi/m ² truall	Sip are	Çmimi/m ² are	Objekt Vlera në lekë	Drufrutorë Vlera/lekë	Shuma totale
Petrit Dobroniku	150 m ²	1831 lekë/m ²	200 m ²	851 lekë/m ²	2 193 973	77 500	2 716 323

Vlera totale e shpronësimit është 2 716 323 (dy milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e

treqind e njëzet e tre) lekë